



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2077 prot.

Pukë, më 31.10. 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. 14 Datë 31.10. 2023

PËR PROPOZIM PËR SHPALLJE “DËSHMOR I ATDHEUT”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, ”Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 109/ 2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5, pika a), neni 8, pika 1), neni 10, pika 3) dhe 4), neni 11, si dhe VKM nr. 151, datë 24.04.2022 “ Për statusin Dëshmor i Atdheut”, i ndryshuar:

VENDOSI

1. T’i propozojë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, Z. Rrustem Rexhep Kabashi, me motivacion: **“Për organizimin e kryengritjeve për mbrojtjen e të drejtave kombëtare shqiptare dhe të trojeve kombëtare shqiptare me përkrahjen dhe mbrojtjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878 e në vazhdim, duke kundërshtuar me armë zbatimin e reformave antishqiptare të xhon turqve (turqit e rinj), duke pranuar varjen në litar me 18 gusht 1910, se sa nënshtrimin me tradhëtinë e interesave kombëtare shqiptare”**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Rrok DODAJ

Në mungesë dhe me urdhër
ZV. KRYETARI
Ferit RINGAL



Drejtori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Sokol GJONI

Përgjegjësi i Sektorit Juridik
Endrit KRAJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2077/ prot.

Pukë, më 31.10. 2023

RELACION

Mbi

Projekt-vendimin për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”,

Z. Rrustem Rexhep Kabashi,

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, ”Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5, pika a), neni 8, pika 1), neni 10, pika 3) dhe 4), neni 11, si dhe VKM nr. 151, datë 24.04.2022 “ Për statusin Dëshmor i Atdheut”, i ndryshuar: *relatojmë si më poshtë:*

Projekt vendimi për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, Z. Rrustem Rexhep Kabashi, drejtuar Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, paraqitet para jush, me propozim të Organizatës së Dëshmorëve, dega Pukë, si dhe me iniciativë të Shoqatës së Historianëve Ushtarakë Shqiptarë.

Nisur nga sa më sipër, dhe në njohje të dokumentacionit të paraqitur për veprimtarinë e tij në mbrojtje të interesave kombëtare, ju ftoj të votoni projekt-vendimin për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, Z. Rrustem Rexhep Kabashi, të paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Bashkëlidhur:

- ✓ Projekt-vendimi “Projekt vendimi për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, Z. Rrustem Rexhep Kabashi,
- ✓ Dosja me dokumentacionin njohës mbi jetën dhe veprën e z. Rrustem Rexhep Kabashi.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

367/1
Nr. prot.

Shkodër, më 25.5.2023.

Lënda: Për ndjekje.

KËSHILLIT BASHKIAK PUKE

Për njoftim: SHOQATES TE HISTORIANEVE USHTARAKE SHQIPTARE
TIRANE ✓

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr. 107 datë. 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenit 11, pika 2 të Ligjit Nr.109/2018 "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", bashkëlidhur po ju dërgojmë për trajtim kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues Nr.05/01 prot datë.5.05.2023 të Shoqatës së Historianeve Ushtarake Shqiptarë, Tiranë, meqenëse se *Z. Rustem Rexhep Kabashi*, ka qene banorë nga fshati Kabash, NJAD Rrape, Bashkia Puke.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI



Republika e Shqipërisë

Organizata e Dëshmorëve të Atdheut Dega Pukë

duke u mbështetur në dokumentat e bashkangjizur

I PROPOZON


**Këshillit TË BASHKISË PUKË miratimin të shpalljes Dëshmor I Atdheut Rustë
Kabashi**

Për Kryesinë ODA Dega Pukë

Sekretari Xhemal Meçi



Kryetari Rasim Cina





Rrustë Kabashi, Sulejman Vokshi



*Lef Nosi ne mes
dy burra kabashas*

Lef Nosi në mes të burrave të Kabashit

Rustem Kabashi (Rustë Kabashi) 1835-1910



Haxhi Rustë Kabashi

RRUSTË KABASHI

1835 - 18 gusht 1910

Pr. Dr. Isuf Bajraktari, Rrustë Kabashi – figurë e shquar e kryengritjes së vitit 1910;

Studiuesi Sabri Maxhuni Novosella, Haxhi Rrustë Kabashi, Hero i Linjes Kombëtare;

Gjeneral Rrahman Parllaku, Nderi i Kombit, “ Atdhetari Rrustë Kabashii, njëri nga udhëheqësit e luftërave për liri e Pavarësi Kombëtare,”

Pr. Dr. Shefqet Hoxha, Dukentat dhe këngët popullore dëshmojnë se Haxhi Rrustë Kabashi ishte një atdhetar i shquar popullor kundër reformave anti antishqiptare të gjon turqve, të cilët në pamundësi për ta nënshtruar e varën në litar më 18 gusht 1910, gjë që e tregon qart se për ke u përpoq dhe luftoi AI, u përpoq për ADHETARI.

Rrustë Kabashi emërin e vërtetë e kishte Rrustem, Rrustem Rexhep Balë Hasan Alia, **Hasanali**. Mbasi u vendos në Kabash të Prizrenit ku me punë të pareshtur 9 ME LEJEN E VENDASVE ndërtoi 3 mullinj me ujë) kështu që vuri pasuri dhe njëkohësisht arriti të ketë ndikim të madh në djelmëninë e Kabashi dhe jo vetëm, duke marrë famë për cilësitë e tija morale si: **punëtor i papërtuar, guximtar, trim, besnik, bujar, kuvendtar i urtësisë, i komunikueshëm, pleqnar e pajtimtar i sukseshëm konfliktesh e gjakmrrjesh; luftëtar e prijës djelmnie, i vendosur e i papajtueshëm dhe i panënshtrueshëm** edhe vetëm pas një rezistente sadoqë me shumë sakrifica njerëzore e pasurore mbi 150 vjeçare duke u kushtuan shumë humbje edhe pushtuesve osmanë aq sa u detyruan t’ua njihnin një autonomi vetqeverisjeje vendore dhe **të drejtën e mbajtjes së armëve në bajrakun e vet**. Kurse në Kabashin e Prizrenit dhe zonat fushore këto të drejta ishin të kufizuara dhe të pa siguruara. Duke u ndodhur në kushte të tilla Ai filloi të përkrahte çdo revoltë popullore të Kosovës. Kështu u bë i njohur si luftëtar dhe prijës i luftëtarëve Kabashës e Kosovarë. njohur në Prizren dhe jo vetëm si luftëtar i paepur dhe prijës i rëndësishëm me emrin HAXHI RRUSTË KABASHI (me shkurtimin e emrit nga Rrustem në RRUSTË, ndërsa në dokumenta shkruhej Rustë. Por krejtë gabim dhe padrejtësisht, kundërshtarët e Tij e quajnë Bobçor. Tek ne në Pukë ka kaptim fytes dhe i vëhet dikuj kryesisht për smirë, duke ia lënë si noftë. Në ndonjë shkrim apo botim është fut bobçor Nabashi i vendit me autor Rrahman REXHAJ.) .

Kurse KABASHI i Prizrenit e mori këtë emër prej banorëve kabashas, që u vendosën aty nga mesi i shek. XVIII , sakt se kur erdhën dhe nga erdhën duke u ndarë nga trangu me Kabashin e pukës. I këtij mendimi edhe Studiuesi me përmasa akademike prof Ekrem ZENELAJ) Por ka asish që i besojnë këtij shpjegimi. Një punë të mirë e ngulmim ka punuar në këtë drejtim studiuesi Rrahman Rexhaj.

E vertetë është se në regjistrat osmane të she. XVI del se Gjin Kabashi, kefali është vendosur më 1570 me 20 shtëpi (familje)në Rrape , Dukagjin. Dhe ashtu, siç thotë edhe Nopça, kabashët, si pranuan nga ortodoks të kalonin nga ortodoks në besimin islam, u vendosën në Shinpal dhe për pasojë Shpali, prej ku pak nga pak mori emrin e këtij fisi ardhës, KABASH, nga që kabashët përbënin qendrën e vendbanimit të tyre, në ish-pronat e Furrikut për t'iu gjetë krah (FURRIKU ishte edhe krenë edhe bajraktar). Në Shekuj edhe fiset vendas: Kokajt, Hadrojt dhe Lushajt, të pakësuar nga emigrimet =, iu mbështetën fisit kabash duke formuar kështu "4 vllazni": "vëlleznia e Kokë Lekës, Qafë Lekës, Hadër Lekës dhe Lush Lekës". Toka e pakët dhe varfërimi i vendit nga pakësimi i trafikut nëpër Udhëpukë (Viapublika Adriatik-Danubi Jugor-Odesë e kthim) vazhdoi emigrimi që në Itali e arbëreshët, ku vendbanimit i tyre i ri mori emrin: " Puhare" (Puka e Re, siç e ka hulumtuar e vizituar studiuesi pukas Jaho Brahaj nga fillimi i vitit 1900). Po emigrimi vazhdoi në Kosovë, Dubrovnik (ku Gazullorët janë bërë të famshëm me Gjon Gazullin akademik); po kështu kanë emigruar në Bregdet, Lumë, Dibër etj.

Tradita (kujtesa historike siç e kam mbledhur unë në Korishë të Kabashit të Prizrenit, së pari, më 18 qershor 2004 dhe në vazhdim, më 14 tetor 2005 e tjerë herë pas here me ndihmën e Lulzim Kabashit dhe të Ferit Rustë Kabashit) dëshmon se dy djemtë e **Hadër** Lekës nga Kabashi i Pukës: AHMETI dhe ZENELI me familjet e tyre të mëdha shkuan në Prizren. Simbas brezave të trashëgimtarëve del se Vëllezërit HADRI (ZENELI e AHMETI) aty nga vitet 1700 ngulën në vendbanimin e ri , të cilit i dhanë emrin **KABASH**, Duke u bërë i njohur në tërë rrafshin e Dukagjinit me emrin e ri KABASHI i PRIZRENIT.ka mendime se ky ngulim është nga një rikthim i kabashëve nga diku në Kosovë., prandaj për dallim e quajnë KABASHI I VENDIT:. Nga ambicja e famës që mori Kababashi , dikush ka guxim se Kabashi është vëlla i vogël i Thaçit , pra si nëndegë e Thaçit. Po në Kosovë rreziku i përhershëm sllav i ka bërë fiset në Kosovë të quhen vëllezr. Jemi një jemi VËLLEZËR.

Qazim Sulejman Kabashi, (Zenelaj), pjesëmarrës në Batalionin II UÇK-ës, i diplomuar për Histori, drejtor i shkollës 9-vjeçare të Korishës, në vitet 2001-2004 ish-deputet në parlamentin e Kosovës tregon (më 14 tetor 2005) se ai vend, ku u vendosën kabashët, kishte qenë i banuar që në lashtësi, siç e tregojnë rrënojat e një muri rrethues me një perimetër më të madh se ai i Kalasë së Prizrenit. Brenda gërmadhave aty u zbuluan nga arkeologët e Prishtinës, më 2002, një kishë paleokristiane, si dhe rrënojat e 13 kishëve në afërsi të saj. Xhevxhet Kadri Adem Kabashi, (AHMETAJ), tregoi më 18 qershor 2004, për 10 brezat e vet deri te AHMET Hader Leka:

Zeneli e Ahmeti kur mërritën në Prizren me familjet e tyre filluan të shikonin vendet me radhë se ku u përshtatej ndonjë vendbanim i tillë. Sytë u mbetën te Bjeshka e Iliaz Agës së Prizrenit. Një luginë tërheqëse malore në verilindje të Prizrenit, jo larg qytetit, me një lumë të thellë përmes me ujë të bollshëm e të pastër. Dy anët e malit me podinat përkatëse me diell tërë ditën. Shkurt vend i shëndetshëm e i mirë për jetesë. Hynë në pazar me pronarin, Iliaz Agën, që t'u jepte fundja aq tokë sa mund të mbillej në atë vend me një "kalëthekën." Por theknën e hodhën aq rrallë, sa zunë gjithë podinat e dy anëve të lumit. Kur u rrit thekna, që mbulonte tërë vendin, pronari e kuptoi hilen e kabashëve, porse i pelqei se qenkan mendtar, e të zot, të cilët mund ta përkrahnin me sukses, kur t'i lindte nevoja e tyre. Prandaj i uroi për punën e suksesshme dhe u largua duke buzëqeshur për mençurinë e bulqëve të tij të sapoardhur, me të cilët gjithnjë u tregua i mirëkuptueshëm.

Me kaq dy vëllezërit u ndanë. Duket se Zeneli u tregua më praktik në dae, se i tha Ahmetit vëllait më të madh, e prijës i vëllazërisë: " Ma jep jarmallekun (një lloj palltoje cohe – shenjë) e unë po dal andej", (ana verilindore si pjesë më e vështirë (prandaj më vonë u quajt "Mahalla e Gurit"). Po ai që merrte jarmallekun, palltën cohe, bëhej prijës i dy pjesëve të vëllazërisë.

Banorët e rinj, kabashët, për ta ndjerë vetën më të fortë, duke u siguruar nga një djalëri më e shumtë e më e gatshme për vetmbrojtje vendore, filluan të pranonin edhe fise të vogla "të mbështetë", si: QERRET, **Dakaj** (dakajt fis i fortë e mirënjohës, u shumua sa mori përmasat e një fshati, duke zënë verilindjen e Korishës), **Kukaj** (kukajt mundet dajtë e Rustë Kabashit); **Qerret**, "**Bopaj**". **Bopaj**, duket se u quajtën më vonë, haxhurrustajt për nofkë, nga që u bënë të fortë me Haxhi Rustë Kabashin, sado

që Haxhurrustajt qen paraqitë me emrin Hasanali. Hasan Alia ishte babëgjyshi i Rrustem Rexhep Balë Hasan Alisë, po me Rrustë Kabashin u bënë të njohur si **Haxhurrustaj**; por *Haxhi Rrusta si vetë si edhe pasardhësit e Tij u treguan gjithnjë dashamirës e të mirëkuptueshëm me të gjithë Kabashasit, të nisur nga fjala e urtë: " Trimi i mirë me shokë shumë!"* Prandaj Kabashi i përgjigjej në çdo kusht. Dhe bashkë me te edhe gjithë Përdrina.

Tani lind pyetja se nga erdhi aty Rrustem Kabashi, nga ishte **vendlindja dhe Vëllazëria e Tij?**

Në Pukë, në lagjen Laçaj thuhet (sidomos Kapllan Ismail Laçi, njohës i mirë i Traditave të Laçajve deri edhe i mbarë Pukës katund, se Haxhi Rrustë Kabashi është Laçaj, me origjinë si edhe ata vetë laçajt, prej vëllazërisë së mirënjohur lushaj, të Lush Lekës së Kabashit. Lushajt ishin në qendër të Kabashit, në dy anët e udhëpukë me një gjatësi mbi 500 m. deri te abacia e Shën Palit mbi Gominë. Pjesa e tyre qendërore formonte një hapësirë që njihet me emrin Lamlushaj, në jug të këtij Lami ishte kisha e Shën Gjonit; kurse aty rreth 300 vjet më parë, më në jugperëndim u ndërtua Xhamia e Kabashit. Rapsodi Prendush Gega, "Artist i Merituar" u ka thurë vargje këtyre dy institucioneve fetare për harmonin shembullore mes komuniteteve të tyre fetare: " Ti n' Kabash ndoj herë je kanë./ A ke pa ni xhami n' Lamë?!/ Derë për derë kishë e xhami!/ Turk (myslimanë) e t' kshtenë ishin kojshi!" Në mes të Xhamisë e Kishës, Lamlushaj bëheshin **kuvendet** e shtatëbajrakëve të Pukës dhe **Panairi** Pranveror i Kabashit , të dielën, një javë para Pashkëve Katolike. Por për Lamlushaj thuhej se aty " kishin pjesë Dardhçorë e Gazullorë " si Kabash. Dihet se Dardha, është katund në verilindje të rrethit të Pukës, krenare që është prej kabashi. Po kështu edhe Gazullorët e Kahnjetit, siç e thonë ata vetë " janë me origjinë prej Kabashit të Pukës". Në Kahnjet shtrihen në dy lagje me emrin: Gjazuj(Gazujt) e Epërm dhe Gjazujt e Poshtëm. Po kështu, edhe dom Nikollë Gazulli shprehet: "Ne gazullorët jemi fis Kabashi".

Si dardhëçorët, si gazullorët kudo u treguan trima, punëtorë, aq sa Gazullorët e dubrovnikut rreth vitit 1300 morën famë me Gjon Gazullin akademik, sa Mbreti i hungarisë , Matias, e kërkoi për rektor Universiteti në Budapest. Këtij Geni i përkisnin edhe Laçajt me Ismail Laçin e Parë, në një familje të madhe e të fuqishme, që ju bë krah në Pukë Bushatlive aq sa Ismail Laçin e I e emëruan Kajmekam në Kaçanikun

problematik, ku I. Laçi tregoi aftësi e zotësi me vendasit duke e kthyer Luginën e Kaçanikut në një udhë të qetë e të sigurtë për udhëtarë, e karvaneve me tregtarë dhe ushtarë. Për këto suksese e lanë me miratimin e tij 12 vjet kajmekam.

Lushajt, që u islamizuen u pranuan prej dizdarit të Pukës në lagjen Laçaj, përballë Qytezës Dukagjini, ku Ai sundonte, që t'i kishte krah. Një prej këtyre si Ismail Isuf Laçi i parë ishte edhe Rustë Rexhep Balë Hasan Alia, prandaj i quanin HASANALI. Nëna e Tij qe bijë e Isuf Kukës së parë, një familje edhe kjo e varfër. Po edhe në Laçaj toka ishte e pakët dhe pylli i largët, kështu, Rrusta vendosi të largohej familjarisht në Kosovë te "vllaznit" e Tij kabashës. Si njeri praktik dhe punëtor i hyri dëshira për ta shfrytëzuar lumin plot ujë verë e dimër të Malit Iliaz aga, duke e kthyer atë lumë në burim pasurish. Mbi te ndërtoi tre mullinj me ujë 24 orë, me mullixhinj të zot të punës e besnikë. Kështu pasuria e tij erdh në rritje, aq sa bleu edhe troje në qytetin e Prizrenit, gjë për të cilën krenohen edhe sot trashëgimtarët e Tij, ndër ta edhe i nderuari Ferit Kabashi, i cili Shprehet: " Haxhi Rustë Kabashi la aq pasuri dhe emër të mirë, sa i gëzojmë edhe ne sot!" Por Rrusta, i mësuar me veqerisjen vendore në **Malet e Dukagjinit (në Pukë)** nuk e duronte dot shtypjen e shfrytëzimin e vendosur në fushë e qytete, prandaj filloi të rebelohej kundër sundimtarëve osmanë dhe të përkrahte revoltat e kundërshtimet e Përdrinës, aq sa qeveritarët osmanë të Prizrenit kërkuan internimin e Rrustës. As internimet dhe burgosjet (katër herë i internuar dhe 4 herë i burgosur), nuk e bënë dot zap. Krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1878 e priti me entuziazëm, duke u vënë me tërë djelmninë e Kabashit në mbrotje të Saj. Shpërndarjen e dhunëshme të LIDHJES prej ushtrisë Osmane me vendim të Kongresit famkeq të Berlinit Rrusta me djelmninë e Kabashit e priti me rezistencë të armatosur, siç e tregojnë vargjet e këngës përkatëse: " Sulejmani (S.Vokshi) hypi n' thep,/ bash si zana po pisket:/ Bini ju Kabash, hej Burra!/ Bini n'thika e n' kacaturra!"...

Në vazhdim nuk pushuan përndjekjet ndaj Tij, sa u detyrua të vinte në Kryezi, Pukë, ku u prit bujarisht bashkë me pasuesit e Tij në kullën e Mustafë Agë Kryeziut. Si pushoi ca ditë i kërkoi ta përcillte në Laçaj te "të kushrijtë " e Tij. Mustafë Aga iu përgjeggj se: "Në Laçaj nuk mund t'ju çoj, sepse Laçajt i kanë kullat fare afer hyqymetit dhe sado kushërijt e tu nuk të lëshojnë pa u shkri krejt, po nuk do të jesh i sigurtë, kurse te kulla ime ke siguri se e kemi malin afër, prej malit dalim në Kunorë Dardhë dhe zbresim në Vadardhë e në Gjakovë a ku don ti." Sa po u kthye në Kabash, Prizren, i vunë

rrethim të fortë me xhandarmëri të shumtë sa arritën ta kapnin në befasi dhe ta internonin më 1902 në Brusë të Anadollit me tërë familjen e tij. Veç djali i madh, Ademi, i cili kishte krijuar familje më veti, mblodhi afro 800 luftëtarë nga Luma e viset përreth dhe hyri në Prizren, të cilin e futi në një rrethim të fortë, duke zënë pikat kyçe të qytetit. Qeveritarëve osmanë të Prizrenit, u kërkoi lirimin e Rustës me gjithë familje. Duke e ndjerë veten të pafuqishëm për ballë rrezikut në rritje ndërhyne në Stambollë që t'i lirojnë familëjart bashkë me Rustë Kabashin. Po ndaj Rustës, për ta mbajtur sa ma larg politikës antiosmane, e çuan në Mekë gjoja për haxhillek. Rusta me t' u kthyer në Prizren përgatiti më 1905 një kryengritje pro amnistisë për lirimin e të dënuarve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Kryngritja mori përmasa të mëdha deri në Qafë Mali të Pukës në sajë të pjesëmarrjes edhe të Mustafë Agë Kryeziut, prandaj Sulltani dekretoi amnistinë e kërkuar. Me që lëvizja e Turqëve të Rinjë (Gjon turqit), që me premtime e mashtrime bënë për vete shuë luftëtarë dhe atdhetarë shqiptar aq sq gjat kryengritje tli viteve 1908 – 1909 morën pushtetin dhe sado që shpallën Kushtetutën dhe filluan reformat me një parlament që kërkonte forcimin e ish-perandorisë osmane me një perandori të fort turke duke shtypur e shfrytëzuar ish kombet që kishin nën sundim. Në këto rrethana skllavëruese u ngrit Kosova mbar dhe malet shqiptare që nga Veriu në Jug duke pasë në drejtim udhëheqjen me prijës të shquar atdhetar, si Ismail be Vlorën, Hasan Prishtinën, Isa Boletinin, Idriz Seferit, Dedë Gjon Luli, Haxhi Rust Kabashi etj. Të cilët organizuan kryengritjen e Kaçanikut, Carnalevës, Përdrinës Deçiçit etj. kryengritje që jan përjetësuar në këngë , si "KAÇANIK HE TË RAFT PIKA /QË S' PO DI SE ÇAF ASHT HIKA; /TË MBET VENDI NË FMI E N' ÇIKA!/? Gjasht Sahat T'u Ther me Thika/, Gjasht sahat Po JANË PAK DERI SA NOTOI KALI N' GJAK!

"HAXHI RRUST KABASHI u kap tradhtish në Ferizaj, ku ishte në ndihmë të prapavisë së Idriz Seferit dhe e detyruan nën presionin e litarit e me bojaneta ta shtynin para ushtrisë deri sa hynë në Prizren. Kryengritësit duke e parë se mbetën pa prijsin e tyre, u tërhoqën pa u përleshur me ushtrinë dyzetmijëshe të Shefqet Turgut Pasha. Po **Haxhi Rusta nuk pranoi të nënshkruente aktin e zbatimit të Reforma Turke** që kërkonin çarmatosjen e popullit dhe rekrutimin e djalërisë Kosovare. Po Rust Kabashi tha:" si do të mbrohem ne kështu nga serbo-malazezët! "Ma mirë në **litar** se të mbetem **TRADHTAR!**" Gjygyji ushtarak e dënoi me varje, Para litarit goditi për vdekje një oficer turk duke thirrur:"Haxhi Rust Kabashi ia merr gjakun vetes edhe ditën e Deks.! "

Tri ditë e lanë të varur (18,19 dhe 20 gusht 1910), aq e madhe ishte urrejtja e xhandarmërisë Turke kundër Tij. Po hallin e kishin te heroizmi i Tij , te shembulli i Tij legjendar i LUFTËS PËR LIRI E PAVARËSI TË Poppulli Shqiptar!Prandaj Prof. Shefqet Hoxha shkroi një libër për te, i ndihmuar prej meje me shkrime të rëndësishme botuar në Shypin e kohës së 100-vjetorit të varjes, 18 gusht 1910. Pë kështu kumtesat e mbajtura në promovimin e librit në Pukë, më 5 Nëntor 2022 dhe tani në Prizren 28 Nëntor 2022 . Gjithashtu Këshilli i Bashkisë Pukë me kryetar Enver Sulejmanin dhe kryetarin e Bashkisë PUKË GJON GJONAJ i Akorduan titullin e lartë të Bashkisë Pukë: “ Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë me VENDIM NR: 43, datë 04. 11. 2023 dhe njëkohësisht është propozuar për DËSHMOR I ATDHEUT me motivacionin “Për organizimin e kryengrutjeve për mbrojtjen r të drejtave kombëtare shqiptare dhe të Trojeve Kombëtare Shqiptare me përkrahjen dhe mbrojtjen e LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT 1878 e në vazhdim duke kundërshtuar me armë zbatimin e reformave antishqiptare të Xhon Turqve (Turqit e Rinj) duke pranur varjen në litar më 18 gusht 1910 se sa nënshtrimin me tradhëtinë e interesave Kombëtare Shqiptare.”

Xhemal Meçi studiues, “ MJESHTËR I MADH”


Pukë, tetor 2022.